



Republika e Maqedonisë së Veriut  
Agjencia Për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional

Agjencia Për Mbikëqyrje të  
Financimit Kapital të Sigurimit Pensional  
Nr. 01-1623/3  
14.11.2019-viti  
SHKUP

PLANI FINANCIAR I AGJENCISË PËR  
MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL  
TË SIGURIMIT PENSIONAL PËR VITIN  
2020

## Përmbajtja

I. Hyrje .....	3
I I. Plani financiar për vitin 2020 .....	5
1. TË ARDHURA TË PLANIFIKUARA .....	5
1.2 Kompensime administrative .....	5
1.3 Të ardhura nga kamatat .....	5
2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA .....	6
2.1 Materiale të shpenzuara .....	6
2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale .....	6
2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve .....	6
2.4 Shërbime të tjera .....	7
2.5 Shërbimet e bartjes-transportit .....	8
2.6 Shpenzime për reklama dhe reprezentacion .....	8
2.7 Qiramarrja .....	9
2.8 Shërbime të tjera materiale .....	10
2.9 Provizioni për qarkullim pagesor .....	11
2.10 Premitë e sigurimit .....	11
2.11 Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve .....	11
2.12 Anëtarësime .....	12
2.13 Shërbime intelektuale dhe shërbime të tjera .....	13
2.14 Shpenzime tjera .....	14
2.15 Mjete për punë ndërtimore .....	14
2.16 Mjete për pajisje .....	14
2.17 Mjete të tjera kapitale .....	14
2.18 Paga dhe kompensime të kalkuluara .....	15
2.19 Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati .....	15
Shtojca 1 Pasqyra analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve .....	16
Shtojca 2 Shpenzime që do të mbulohen nga fondit rezerv në vitin 2020	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Shtojca 3 Rezultati i planifikuar financiar për vitin 2020 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

# Plani financiar për vitin 2020 i Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)

## I. Hyrje

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejshëm: Agjencia) është trup rregullator i pavarur dhe i mëvetësishëm i formuar në bazë të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113 /2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016 dhe 21/2018) (në tekstin e mëtejshëm: Ligji)

Në pajtim me nenin 46 të Ligjit, Agjencia ka cilësi të personit juridik me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj dhe me statutin. Organ Drejtues dhe Mbikëqyrjes i Agjencisë është Këshilli i Ekspertëve, ndërsa për punën e tij përgjigjet para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Qëllimi i themelimit të saj është mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondeve pensionale dhe nxitja e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital. Agjencia është themeluar për të realizuar mbikëqyrje të punës së shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhim me fondet vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: shoqëritë pensionale) dhe fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: fondet pensionale).

Në pajtim me nenin 47 të Ligjit, Agjencia është kompetente që të:

- japë, tërheqë dhe marrë lejet për themelimin e shoqërive pensionale dhe lejet për menaxhim me fondet e detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale;

- të mbikëqyrë punën e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale me të cilat menaxhojnë, si dhe të ruajtësve të mjeteve të fondeve pensionale të menaxherëve të huaj të mjeteve;

- promovojë, organizojë dhe nxisë zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe ta rrisë vetëdijen e publikut për qëllimet edhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale;

- miratojë akte në pajtim me Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital, Ligjin për sigurim vullnetar pensional me financim kapital dhe Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve pensionale në sigurimin pensional me financim kapital, si dhe udhëzimet profesionale, doracakët, etj., në lidhje me sigurimin pensional me financim kapital dhe të iniciojë miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera në lidhje me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale me të cilat menaxhojnë.

Puna e Agjencisë në pajtim me nenin 56 paragrafi (3) të Ligjit, financohet nga kompensimet të cilat i arkëton Agjencia nga shoqëritë pensionale (kompensim mujor nga secila shoqëri pensionale dhe kompensime administrative). Pëlqimi për shumën e kompensimit jepet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në bazë të propozimit të përcaktuar nga ana e Këshillit të Ekspertëve të Agjencisë.

Shuma e kompensimit mujor që e arkëton Agjencia nga shoqëritë pensionale, përcaktohet në bazë të analizës për nevojat e Agjencisë për realizim optimal të kompetencave të përcaktuara dhe duke

respektuar parimin e minimizimit të shpenzimeve. Në këtë drejtim, vërehet trend rënës i shumës së kompensimit prej 1,5% në vitin 2006 dhe 2007, në 1% në vitin 2008 dhe 2009 dhe prej 0,8% në vitin 2010 deri në vitin 2018. Shuma e kompensimit mujor prej 0,8% të kontributeve të përgjithshme, të paguara gjatë muajit të kaluar në secilin fond pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, planifikohet edhe për vitin 2019.

*Propozim-plani financiar i Agjencisë për vitin 2020 është përcaktuar në bazë të:*

- Realizimit të Planit Financiar për vitin 2019.
- Kompensimeve të pritshme dhe të ardhurave tjera gjatë vitit 2020.
- Realizimi i aktiviteteve të filluara dhe aktiviteteve të reja sipas programit vjetor të punës së Agjencisë për vitin 2020 dhe
- Shpenzimet e planifikuara për vitin 2020.

## II. PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2020

Në bazë të supozimeve të theksuara paraprake, për vitin 2019 planifikohen këto të ardhura dhe shpenzime të Agjencisë.

### 1. TË ARDHURA TË PLANIFIKUARA

Gjatë vitit 2020, planifikohet që Agjencia të realizojë të ardhura të përgjithshme prej 64.050.000 denarë, struktura e tyre sipas burimit të mjeteve është si vijon:

1.1 Kompensimi nga kontributet e shoqërive pensionale	60.000.000 denarë
1.2 Kompensime administrative	3.200.000 denarë
1.3 Të ardhura nga kamatat	850.000 denarë

TË ARDHURA TË PËRGJITHSHME TË PLANIFIKUARA 64.050.000 denarë

Shuma e planifikuar e të ardhurave nga kontributet e shoqërive pensionale prej 60.000.000 denarë pritet që të realizohet me arkëtimin e kompensimit mujor nga shoqëritë pensionale prej 0,8% të kontributeve të përgjithshme, të paguara gjatë muajit të kaluar në secilin fond pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale. Të ardhurat e planifikuara nga kompensimi mujor janë të përlogaritura në bazë të kontributeve të projektuara me projektimet aktuale të Fondit të SPIM për vitin 2020 të marra nga viti 2015 dhe duke marrë parasysh se në vitin 2019 nga Fondi i SPIM nuk ka përditësuar projekte, Agjencia realizoi vlerësime në bazë të të dhënave të kaluara dhe në bazë të projekteve buxhetore në klasën e shpenzimeve tranzituese nga Fondi i SPIM.

Shuma prej 3.200.000 denarë paraqet të ardhura në bazë të kompensimeve administrative, shuma e të cilave projektohet në nivel përafërsisht të njëjtë siç është realizuar edhe në vitet paraprake.

Shuma prej 850.000 denarë janë të ardhura të planifikuara nga kamatat që Agjencia pritet t'i arkëtojë nga depozitat e afatizuara nga fondi rezervë i bankave të caktuara, në pajtim me Vendimin për shpërndarjen dhe investim të tepricës së të ardhurave të Agjencisë.

## 2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA

Gjatë planifikimit të shpenzimeve për punën e Agjencisë gjatë vitit 2020, është marrë parasysh shpenzimi racional i mjeteve të nevojshme për realizimin kualitativ, efikas dhe të vazhdueshëm të detyrave, obligimeve dhe kompetencave të Agjencisë që dalin nga Ligji për sigurim pensional me financim të detyrueshëm kapital.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2020 planifikohen që të jenë 6.3.785.000 denarë dhe planifikohen që të shfrytëzohen për nevojat si vijon:

### 2.1 Materiale të shpenzuara

Për furnizim me materiale të nevojshme për funksionimin e përditshëm të Agjencisë, në vitin 2020 janë planifikuar të shpenzohen 610.000 denarë edhe atë për blerjen e:

- Derivateve;
- Materialeve për zyrë dhe
- Inventarit të imët

Shpenzimet e planifikuara për Materialet e shpenzuara në vitin 2020 janë më të larta për 7,01% krahasuar me shpenzimet e planifikuara për të njëjtën bazë gjatë vitit 2019.

### 2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe pagesën e shërbimeve komunale gjatë vitit 2020, janë planifikuar shpenzime në shumë prej 1.200.000 denarë edhe atë për:

- Energji elektrike dhe
- Ujë, shpenzime të tjera komunale dhe ngrohje qendrore

Shpenzimet e planifikuara për Energjinë e harxhuar dhe shërbimet komunale në vitin 2020 janë në të njëjtin nivel në raport me shpenzimet e planifikuara për të njëjtën gjë gjatë vitit 2019.

### 2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve

Shpenzimet e planifikuara për Mirëmbajtje investuese të mjeteve janë 370.000 denarë edhe atë për:

- Instalim dhe mirëmbajtje të sistemit të zjarrit

Shpenzimet e planifikuara për sistemit të zjarrit në vitin 2020 janë dukshëm më të larta, krahasuar me shpenzimet e planifikuara për të njëjtën gjë gjatë vitit 2019 për shkak të nevojës së instalimit të një sistemi për mbrojtjen nga zjarri në vitin 2020.

### 2.4 Shërbime të tjera

Mjetet e vlerësuara për atë kategori të shpenzimeve me shumë të përgjithshme prej 11.910.000 denarë, planifikohen që të dedikohen për:

- Mirëmbajtje të softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional;
- Mirëmbajtje të softuerit për arkivin;
- Mirëmbajtje të softuerit për kontabilitet;
- Shërbime për lokacion sekondar;

- Dërgesa postare;
- Mirëmbajtje higjienike të hapësirave;
- Shërbime të telekomunikimeve;
- Shërbime për botim, kopjim dhe konvertim të letrave;
- Kompensim dhe për hapësirat e parkimit;
- Mirëmbajtje dhe servisim të automjeteve;
- Mirëmbajtje të pajisjes teknike dhe
- Rregullime të objektit zyrtar
- Organizim të evenimenteve për zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime tjera janë për mirëmbajtjen e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional, mirëmbajtjen e IBM pajisjes harduerike, mirëmbajtjen e softuerit për arkivin dhe kontabilitetin dhe orët e punës për mirëmbajtjen e atyre softuerëve nga ana e një firme të jashtme për teknologji informatike. Lokacioni sekondar është i nevojshëm për të mbrojtur të dhënat dhe aplikacionet, si dhe mbrojtjen e mosfunksionimit të pajisjeve ose mosqasjes së lokacionit primar të parametrave informatike. Në këtë drejtim, blihet zgjidhja komplete e subjektit të jashtëm në largësi minimale prej 100km largësi rrugore dhe 80km largësi ajrore nga lokacioni primar. Posedimi i lokacionit sekondar dhe pajisjeve për parametra informatike është një hallkë e rëndësishme në sistemin e menaxhimit me sigurinë e informatave për autorizim dhe përvokueshmëri.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime të tjera në vitin 2020 janë më të larta për 92,4% krahasuar me shpenzimet e planifikuara në këtë bazë për vitin 2019 për faktin se shpenzimet për organizimin e evenimenteve për promovimin dhe zhvillimin e sigurimit pensional me financim kapital, si dhe mirëmbajtjen e IBM pajisjes harduerike që deri më tani janë financuar nga fondi rezerv i Agjencisë, në vitin 2020 planifikohen që të financohen nga plani vijues financiar.

Shpenzimet e planifikuara për shërbime për promovimin, organizimin dhe nxitjen e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital janë 5.000.000 denarë. Në vitin 2020, agjencia planifikon aktivitete për organizimin e evenimentit “15 Shtatori – Dita e Ndërgjegjësimit pensional”, e cila mbahet çdo vit rreth datës 15 shtator. Do të ketë gjithashtu shpenzime më të mëdha për promovimin e sistemit, me qëllim të përforcimit të vetëdijes së publikut për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, për përfitimet e anëtarësimit në fond të detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, përfshirë edhe qëllimet, parimet dhe përfitimet e pjesëmarrjes në skemën pensionale profesionale për të drejtat e anëtarëve dhe fondet e detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për çështje të tjera që lidhen me sigurimin pensional të financuar nga kapitali, që është edhe detyrim ligjor i Agjencisë.

Shpenzimet e planifikuara për Mirëmbajtjen e pajisjeve harduerike IBM arrijnë 1.200,0 denarë. Shpenzimet janë planifikuar për mirëmbajtjen e rregullt, shërbimin dhe zëvendësimin eventual të pajisjes jofunksionale.

## 2.5 Shërbimet e bartjes-transportit

Për blerje të shërbimeve për bartje - transport të taksive për nevojat e Agjencisë në vitin 2020 janë planifikuara 80.000 denarë.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbimet e bartjes-transportit në vitin 2020 janë më të ulëta për 11.11%, krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2019.

## 2.6 Shpenzime për reklama dhe reprezentacion

Për reklama dhe reprezentacion në vitin 2020 janë planifikuara shpenzime prej 800.000 denarë të dedikuara për:

- Reprezentacion dhe
- Shërbime për botimin e materialit reklamues

Shpenzimet e planifikuara për reklama dhe reprezentacion në vitin 2020 janë më të larta për 14,28% krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2019. Rritja ka të bëjë me rritjen e nën zërit Shërbime për botim të materialit reklamues për shkak të rritjes së numrit të evenimenteve për edukim financiar dhe inkluzion financiar të publikut, në të cilat merr pjesë Agjencia.

Shpenzimet e planifikuara për Reprezentacion kanë të bëjnë me organizimin e evenimenteve zyrtare dhe prokurimet për nevojat e Agjencisë.

## 2.7 Qiramarrja

Për vitin 2020 janë planifikuar shpenzime në shumë prej 1.010.000 denarë për:

- Qiramarrje të sallave dhe amfiteatrove;
- Qiramarrje të linjës së internetit;
- Qiramarrje të pajisjeve të tjera dhe
- Qiramarrje (lizing) të automjeteve.

Mjetet e planifikuara për qiramarrje janë për marrje me qira të sallave dhe amfiteatrove për nevojat e Agjencisë, marrje me qira të linjës së internetit dhe pajisjeve të tjera, respektivisht të printerëve dhe skanerëve për nevojat e Agjencisë dhe marrje me qira (lizing) të automjeteve.

Shpenzimet e planifikuara për qiramarrje për vitin 2020 janë në të njëjtin nivel krahasuar me shpenzimet e planifikuara në të njëjtën bazë gjatë vitit 2019.

## 2.8 Shërbime të tjera materiale

Në zërin Shërbime të tjera materiale janë planifikuar shpenzime në shumë prej 365.000 denarë për:

- Blerjen e revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe të ngjashme;
- Pagesë të kompensimit për shkëmbimin e të dhënave të bursave dhe shpenzimeve të arkës – materiale;
- Shpenzime për blerjen e mjeteve higjienike;
- Sigurim teknik dhe patrullues të hapësirave të Agjencisë;
- Shpenzime për regjistrim dhe kontroll teknik të automjeteve dhe
- Shërbime për deratizim dhe dezinfektim

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime të tjera materiale për vitin 2020 janë më të ulëta për 1,35% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019.



## 2.9 Provizionin për qarkullim pagesor

Mjetet e kësaj kategorie shpenzuese janë 60.000 denarë, ndërsa kanë të bëjnë me provizionet e qarkullimit pagesor dhe provizionet bankare për blerje të devizave.

Shpenzimet e planifikuara për Provizionin e qarkullimit pagesor për vitin 2020 më të larta për 50% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019 për shkak të rritjes së shpenzimeve për provizionet bankare gjatë vitit 2019.

## 2.10 Premitë e sigurimit

Për vitin 2020 janë planifikuara shpenzime në shumë prej 130.000 denarë për:

- Sigurimin e të punësuarve të Agjencisë;
- Sigurimin e udhëtarëve për udhëtime zyrtare jashtë vendit;
- Sigurimi i objektit zyrtar nga fatkeqësitë dhe
- Sigurimi i automjeteve zyrtare

Shpenzimet e planifikuara për Premitë e sigurimit për vitin 2020 janë më të ulëta për 18,75% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019.

## 2.11 Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve

Shuma e planifikuar e shpenzimeve për udhëtime zyrtare në vend dhe jashtë është vlerësuar në 1.600.000 denarë. Këto shpenzime përfshijnë: shpenzime për akomodim, ushqim dhe transport (mëditje për udhëtim zyrtar, shpenzime për bujtje dhe shpenzime të tjera në lidhje me ato udhëtime). Mëditjet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit rregullohen me Aktvendim për shumat më të larta të mëditjeve për udhëtime zyrtare dhe transfere jashtë vendit, shpenzime që u pranohen organeve të administratës shtetërore si shpenzime vijuese (Gazeta zyrtare e RM-së nr. 19/14 që është në fuqi prej datës 01.01.2015).

Shpenzimet e planifikuara për Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve për vitin 2020 janë më të larta për 14,28% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019 për shkak të planifikimit të rritjes së pjesëmarrjes së të punësuarve në trajnime gjatë vitit 2020, në pajtim me rekomandimet për forcimin e kapaciteteve njerëzore nga raportet e Komisionit Evropian dhe Bankës Botërore.

## 2.12 Anëtarësime

Planifikohet që gjatë vitit 2020 Agjencia të paguajë 440.000 denarë për:

- Anëtarësi vjetore në IOPS - Organizatën Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve Pensionalë;
- Anëtarësi vjetore në Organizatën e Punëdhënësve të Maqedonisë;
- Anëtarësi vjetore në INFE – Rrjetin ndërkombëtar të Arsimit Financiar dhe OECD – Organizatën për bashkëpunim dhe zhvillim ekonomik dhe
- Anëtarësi vjetore në Shoqatën e revizorëve të brendshëm.

Shpenzimet e planifikuara për Anëtarësime për vitin 2019 janë në të njëjtin nivel krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2018.

## 2.13 Shërbime intelektuale dhe shërbime të tjera

Shpenzimet e planifikuara për shërbime intelektuale dhe shërbime tjera për vitin 2020 janë në shumë prej 2.588.000 denarë. Planifikohet që ato të shfrytëzohen për pagesë për:

- Kompensim për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve;
- Shërbime të tjera – vlerësues, noter;
- Përkthime të teksteve;
- Lektorim të teksteve;
- Revizion të jashtëm;
- Shërbime konsultuese;
- Trajnime për përsosje profesionale, seminare dhe konferenca;
- Shpenzime për realizimin e trajnimeve për agjentë;
- Ricertifikim ISMS-ISO 27001;
- Ricertifikim ISO 9001;
- Hululumtim të mendimit publik dhe
- Shpenzime për siguri dhe shëndet gjatë punës”.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbime intelektuale dhe shërbime tjera për vitin 2020 janë më të larta për 15,79% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019 për shkak të nevojës së angazhimit të konsulentëve për nevoja të Agjencisë për plotësimin e rekomandimeve të dhëna nga institucionet ndërkombëtare, kontroll sistematik për të punësuarit dhe vëllimit të shtuar të materialeve për përkthim në gjuhën shqipe gjatë vitit 2020.

#### 2.14 Shpenzime tjera

Në zërin e Shpenzimeve tjera për vitin 2020 janë planifikuar shpenzime në shumë prej 320.000 denarë që përfshijnë shpenzime për shpalljen e konkurseve dhe publikimeve në gazeta, shpallje të prokurimeve publike, akontacione për tatim të shpenzimeve të papranuara dhe shpenzime të tjera publike që kanë të bëjnë me institucionet publike/shtetërore dhe shpenzime të tjera për punë të paparashikuara.

Shpenzimet e planifikuara për Shpenzime të tjera për vitin 2020 janë më të larta për 33,33% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019

#### 2.15 Mjete për punë ndërtimore

Në zërin Mjete për punë ndërtimore janë paraparë shpenzimet për zgjidhjet arkitektonike për rikonstruktimin e objektit. Vlera e përgjithshme e llogaritur e kësaj kategorie të shpenzimeve është 1.230.000 denarë.

Shpenzimet e planifikuara për Mjete për punë ndërtimore për vitin 2020 janë më të ulëta për 88% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019, sepse në vitin 2020 nuk është planifikuar rikonstruktimi i dyshemesë së Agjencisë, për shkak të dëmtimeve të vërejtura në disa pjesë të saj.

#### 2.16 Mjete për pajisje

Në zërin Mjete për pajisje për vitin 2020 janë planifikuar shpenzime në shumë prej 1.050.000 denarë.

Gjatë vitit 2020, Agjencia do të ketë nevojë edhe për blerje të pajisjeve kompjuterike, printerë, ups dhe pajisje të tjera informatike-teknike për nevojat e të punësuarve në Agjenci.

#### 2.17 Mjete të tjera kapitale

Në zërin Mjete të tjera kapitale për vitin 2019 janë planifikuar shpenzime në shumë prej

7.280.000 denarë për:

- Mobilie për zyrë;
- Licenca Windows;
- Mbrojtje antivirus për Checkpoint 4400 – parapagesë vjetore;
- Softuer kompjuterik – softuer i ri dhe
- Shpenzime për pjesëmarrje për shfrytëzimin e softuerit për organizim dhe dhënie të provimeve për marrjen e licencës për agjent në bazë të marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së RM-së dhe Agjencisë.

Shpenzimet e planifikuara për Mjete të tjera kapitale për vitin 2020 janë më të ulta për 0.41% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019.

Shpenzimet për mbrojtje antivirus dhe softuer të ri kompjuterik janë shumë më të rëndësishme sepse Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional si trup mbikëqyrës është pjesë qendrore e sistemit të lidhur informatik përmes të cilit realizohen proceset zyrtare të sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Mjetet e softuerit të ri kompjuterik do të dedikohen për shtimin e funksionaliteteve dhe ndryshimeve të reja ndaj aplikacioneve softuerike që kanë të bëjnë me krijimin e sistemit të menaxhimit me sigurinë e informatave për autorizimin dhe përvokueshmërinë e shfrytëzuesve. Plotësimet e planifikuara dhe ndryshimet janë për shkak të plotësimit të obligimeve ligjore dhe veprimit sipas rekomandimeve konsultuese të revizioneve të jashtme. Funksionalitetet për autorizimin dhe përvokueshmërinë e shfrytëzuesve paraqesin ruajtje të përhershme të të gjitha veprimeve të ndërmarra nga shfrytëzuesit e sistemeve përkatëse, ruajtjen e përhershme e të dhënave ku kanë pasur qasje shfrytëzuesit, respektivisht logimi me qëllim të mundësimit të përvokueshmërisë së qasjes nga ana e shfrytëzuesit në rast të situatave të ardhshme kontestuese (p.sh, rrjedhja e të dhënave). Prokurimet do të realizohen në pajtim me Ligjin për prokurime publike. Ato konsiderohen si aktivitete investuese duke marrë parasysh kohëzgjatjen dhe madhësinë e vlerës së mjeteve.

Shpenzimet për shfrytëzimin e softuerit për organizimin dhe dhënien e provimeve për të fituar licencën për agjent, në bazë të së cilës pagesa do të bëhet nga mjete personale të Agjencisë, si kompensim i paraparë për mirëmbajtje dhe mbështetje të zgjidhjeve sistematike.

## 2.18 Paga dhe kompensime të kalkuluara

Në zërin Paga dhe kompensime të kalkuluara, janë planifikuar shpenzime në shumë prej 32.600.000 denarë për bruto-paga në pajtim me pozitat e plotësuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Agjenci, kompensimet për të punësuarit dhe për ndihmat e tjera në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive. Në vitin 2020, përveç bruto-pagave për të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve në Agjenci, gjithashtu janë planifikuar edhe mjete për punësim të ri dhe rritje të mundshme të pagave, në pajtim me vendimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet e planifikuara për Paga dhe kompensime të kalkuluara për vitin 2020 janë më të larta për 9,0,3% krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019.

## 2.19 Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati

Në zërin Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati për vitin 2019 janë planifikuara shpenzime në shumë prej 150.000 denarë që kanë të bëjnë me shpenzime për tatimin personal në bazë të pagesave të kompensimeve për anëtarët e jashtëm të Këshillit të ekspertëve dhe të tjerë.

Shpenzimet e planifikuara për Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultati për vitin 2020 janë më të larta për 25%, krahasuar me shpenzimet e planifikuara gjatë vitit 2019, sipas

projekteve për kompensime dhe shpenzime të tjera për të cilat paguhet tatim personal i të ardhurave, për shkak të tejkalimit të shpenzimeve të pritura për vitin 2019 për të njëjtin zë.

Në pajtim me kategoritë e detajuara të theksuara të planit financiar, planifikohet shumë prej 265.000 denarë si dallim ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2020

Në pajtim me nenin 56-a të Ligjit, nëse gjatë vitit të kaluar zyrtar, Agjencia realizon tepricë të të ardhurave krahasuar me Shpenzimet e realizuara, teprica e realizuar e mjeteve vendoset në fondin rezervë të Agjencisë në shumën e caktuar me planin financiar të Agjencisë.

**Shtojca 1. AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANÇIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL  
PASQYRË ANALITIKE E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE**

Nr.ren d	Përshkrimi	Lejuar 2019	2019				INDEKSI	
			Realizuar deri 30.11.2019	Vlerësimi nga 01.12 deri 31.12.2019	Gjithsej 2019	Vlerësimi 2020/lejuar 2019	7=6/3	Plani 2020
1	2	3	4	5	6=4+5	7=6/3	8	
A	TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA	52.250.000	57.710.920	11.542.184	69.253.104	132,54	64.050.000	
1.1.	Kompensimi mujor nga kontributet (0.8%)	48.500.000	53.898.610	10.779.722	64.678.332	133,36	60.000.000	
1.2.	Kompensime administrative	2.800.000	3.365.475	673.095	4.038.570	144,23	3.200.000	
1.3.	Të ardhura nga kamatat	950.000	446.835	89.367	536.202	56,44	850.000	
B	SHPENZIMET E PLANIFIKUARA	52.228.000	34.786.953	10.991.929	45.778.882	87,65	63.785.000	
1	MATERIALET E HARXHUARA	570.000	277.553	209.827	487.380	85,51	610.000	
1.1.	Karburant	360.000	178.781	120.000	298.781	82,99	400.000	
1.2.	Materiale për zyre	150.000	80.173	69.827	150.000	100,00	150.000	
1.3.	Inventar i imët	60.000	18.599	20.000	38.599	64,33	60.000	
2	ENERGJIA E SHPENZUAR DHE SHËRBIME KOMUNALE	1.200.000	730.473	286.040	1.016.513	84,71	1.200.000	
2.1.	Energjia elektrike	600.000	352.352	160.000	512.352	85,39	600.000	
2.2.	Ujë, shpenzime të tjera komunale dhe ngrohje qendrore	600.000	378.121	126.040	504.161	84,03	600.000	
3	MIRËMBAJTJA INVESTITUESE E MJETEVE	30.000	0	1.180	1.180	3,93	370.000	
3.1.	Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të zjarrit	30.000	0	1.180	1.180	3,93	370.000	
4	SHËRBIME TJERA	6.190.000	3.507.222	1.392.671	4.899.893	79,16	11.910.000	
4.1.	Mirëmbajtja e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional	2.000.000	1.367.030	332.760	1.699.790	97,04	2.000.000	
4.2.	Mirëmbajtja e softuerit për arkivin	0	0	0	0	0,00	1.200.000	
4.3.	Mirëmbajtja e softuerit për kontabilitet	240.000	183.338	49.548	232.886	97,04	240.000	
4.4.	Mirëmbajtja e IBM pajisjes harduerike	150.000	59.472	90.528	150.000	100,00	150.000	

4.5.	Shërbime për lokacionet sekundare	1.200.000	799.992	399.996	1.199.988	100,00	1.200.000
4.6.	Dërgesat postare	750.000	330.661	120.000	450.661	60,09	600.000
4.7.	Mirëmbajtja higjienike e hapësirave	350.000	272.712	58.002	330.714	94,49	300.000
4.8.	Shërbime telekomunikimi	550.000	255.673	127.837	383.510	69,73	550.000
4.9.	Shërbime për botim, kopjim dhe konvertim të letrave	450.000	189.774	90.000	279.774	62,17	350.000
4.10.	Kompensimi për hapësirat e parkimit	30.000	16.800	0	16.800	56,00	30.000
4.11.	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve	350.000	1.514	100.000	101.514	29,00	170.000
4.12.	Mirëmbajtja e pajisjeve teknike	60.000	23.581	14.000	37.581	62,64	60.000
4.13.	Rregullime të objektit zyrtar	60.000	6.675	10.000	16.675	27,79	60.000
4.14.	Organizimi i evenimeve për zhvillim të financimit kapital të sigurimit pensional	0	0	0	0	0	5.000.000
5	SHËRBIME TË TRANSPORTIT	90.000	35.797	40.000	75.797	84,22	80.000
5.1.	Shërbime të transportit	90.000	35.797	40.000	75.797	84,22	80.000
6	SHPENZIME PËR REKLAMA DHE REPREZENTACION	700.000	214.718	244.157	458.875	65,55	800.000
6.1.	Reprezentacion	400.000	148.671	49.557	198.228	49,56	400.000
6.2.	Shërbime për botimin e materialit reklamues	300.000	66.047	194.600	260.647	86,88	400.000
7	Qiramarrje	1.010.000	508.314	258.300	766.614	75,90	1.010.000
7.1.	Qiramarrje të sallave dhe amfiteatrove	30.000	0	0	0	0	30.000
7.2.	Qiramarrje të linjës së internetit	150.000	62.478	20.826	83.304	55,54	150.000
7.3.	Qiramarrje të pajisjeve të tjera	80.000	7.974	2.658	10.632	13,29	80.000
7.4.	Qiramarrje të automjeteve	750.000	437.862	234.816	672.678	89,69	750.000
8	Shërbime të tjera materiale	370.000	180.046	69.403	249.449	67,42	365.000
8.1.	Blerja e revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe të ngjashme	80.000	19.500	18.661	38.161	47,70	50.000
8.2.	Pagesë të kompensimit për shkëmbimin e të dhënave të bursave dhe arkëttimeve – shpenzime materiale	200.000	109.050	27.710	136.760	68,38	200.000
8.3.	Shpenzime për blerjen e mjeteve higjienike	35.000	24.000	4.800	28.800	82,29	60.000
8.4.	Sigurimi teknik dhe patrullues i hapësirave të Agjencisë	35.000	22.896	7.632	30.528	87,22	35.000
8.5.	Shpenzime për regjistrim dhe kontroll teknik të automjeteve	10.000	0	6.000	6.000	60,00	10.000

8.6.	Shërbime për deratizim dhe dezinfektim	10.000	4.600	4.600	9.200	92.000	10.000
------	--	--------	-------	-------	-------	--------	--------

9	PROVIZIONI PËR QARKULLIMIN PAGESOR	40.000	46.266	10.000	56.266	140,67	60.000
9.1.	Provizionet e qarkullimit pagesor dhe provizionet bankare për blerje të devizave	40.000	46.266	10.000	56.266	140,67	60.000
10	<b>PREMI TË SIGURIMEVE</b>	<b>160.000</b>	<b>4.920</b>	<b>110.092</b>	<b>115.012</b>	<b>71,88</b>	<b>130.000</b>
10.1.	Sigurimi i udhëtarëve gjatë udhëtimeve zyrtare jashtë vendit të nëpunësve	70.000	4.920	65.092	70.012	100,02	70.000
10.2.	Sigurimi i objektit zyrtar nga fatkeqësitë	30.000	0	23.000	23.000	76,67	30.000
10.3.	Sigurimi i automjeteve zyrtare	60.000	0	22.000	22.000	36,67	30.000
11	<b>Shpenzime ditore dhe të udhëtimeve</b>	<b>1.400.000</b>	<b>727.263</b>	<b>526.692</b>	<b>1.253.955</b>	<b>89,57</b>	<b>1.600.000</b>
11.1.	Udhëtime zyrtare në vend	400.000	47.188	300.000	347.188	86,80	400.000
11.2.	Udhëtime zyrtare jashtë vendit	1.000.000	680.075	226.692	906.767	90,68	1.200.000
12	<b>Anëtarësim e</b>	<b>440.000</b>	<b>436.953</b>	<b>0</b>	<b>436.953</b>	<b>99,31</b>	<b>440.000</b>
12.1.	Anëtarësi vjetore në IOPS	341.000	339.075	0	339.075	99,44	341.000
12.2.	Anëtarësi vjetore në ORM	40.000	40.000	0	40.000	100,00	40.000
12.3.	Anëtarësi vjetore në INFE –OECD	56.000	55.378	0	55.378	98,89	56.000
12.4.	Anëtarësi vjetore në Shoqatën e revizorëve të brendshëm	3.000	2.500	0	2.500	83,33	3.000
13	<b>Shërbime intelektuale dhe shërbime të tjera</b>	<b>2.228.000</b>	<b>1.109.644</b>	<b>450.020</b>	<b>1.559.664</b>	<b>70,00</b>	<b>2.580.000</b>
13.1.	Kompensim për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve	750.000	565.100	113.020	678.120	90,42	750.000
13.2.	Shërbime të tjera – vlerësues, noter	10.000	12.390	0	12.390	123,90	20.000
13.3.	Përkthime të teksteve	300.000	101.500	198.500	300.000	100,00	400.000
13.4.	Lektorim të teksteve	10.000	0	0	0	0,00	10.000
13.5.	Revizion të jashtëm	150.000	149.410	0	149.410	99,61	150.000
13.6.	Shërbime konsultuese	50.000	0	0	0	0,00	150.000



13.7.	Trajime për përsosje profesionale, seminare dhe konferenca	500.000	207.872	100.000	307.872	61,57	500.000
13.8.	Shpenzime për mbajtje të trajnimeve për edukim të agjentëve	150.000	0	0	0	0,00	100.000
13.9.	Kontroll mjekësor për të punësuarit	0	0	0	0	0,00	100.000
13.10.	Ricertifikim ISMS-ISO 27001	100.000	73.372	0	73.372	73,37	100.000
13.11.	Ricertifikim ISO 9001	72.000	0	31.000	31.000	43,06	200.000

13.12.	Hulumtimi i mendimit publik	100.000	0	0	0	0,00	100.000
13.13.	Shpenzime për siguri dhe shëndet gjatë punës	36.000	0	7.500	7.500	20,83	0
14	<b>SHPENZIME TJERA</b>	<b>240.000</b>	<b>66.359</b>	<b>40.020</b>	<b>106.379</b>	<b>44,32</b>	<b>320.000</b>
14.1.	Publikimi i shpalljeve	60.000	25.560	8.520	34.080	56,80	50.000
14.2.	Akontacione të paguara për tatim të Shpenzimeve të papranuara	150.000	37.699	31.500	69.199	46,13	150.000
14.3.	Shpenzime tjera publike	30.000	3.100	0	3.100	10,33	20.000
14.4.	Mjete për objekte ndërtimore	0	0	0	0	0,00	100.000
15	<b>Zgjidhje arkitekturore</b>	<b>30.000</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0,00</b>	<b>1.230.000</b>
15.1.	Rikonstruktime	30.000	0	0	0	0,00	30.000
15.2.	Mjete për pajisje	0	0	0	0	0,00	1.200.000
16	<b>Pajisje kompjuterike</b>	<b>200.000</b>	<b>122.184</b>	<b>0</b>	<b>122.184</b>	<b>0</b>	<b>1.050.000</b>
16.1.	Shpenzime tjera	200.000	122.184	0	122.184	61,09	1.050.000
17	<b>Mjete të tjera kapitale</b>	<b>7.310.000</b>	<b>6.298.889</b>	<b>984.688</b>	<b>7.283.577</b>	<b>99,64</b>	<b>7.280.000</b>
17.1.	Mobilitet për zyre	300.000	300.000	0	300.000	100,00	200.000
17.2.	Licenca softuerike	80.000	75.213	0	75.213	94,02	150.000
17.3.	Mbrojtje antivirus	400.000	399.292	399.292	399.292	99,82	400.000
17.4.	Softuer të ri kompjuterik	6.500.000	6.216.872	283.128	6.500.000	100,00	6.500.000
17.5.	Shpenzime për pjesëmarrje për shfrytëzim të softuerit dhe organizim dhe dhëni të provimeve për marrjen e licencës për agjentë	30.000	6.804	2.268	9.072	30,24	30.000
18	<b>Paga dhe kompensime të kalkuluara</b>	<b>29.900.000</b>	<b>20.359.931</b>	<b>6.330.000</b>	<b>26.689.931</b>	<b>89,26</b>	<b>32.600.000</b>
18.1.	Paga të kalkuluara	28.400.000	19.294.175	6.000.000	25.294.175	89,06	31.500.000
18.2.	kompensimet dhe për ndihmat e tjera në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive	1.500.000	1.065.756	330.000	1.395.756	93,05	1.100.000
19	<b>Tatime dhe kontribute të cilat nuk varen nga rezultat</b>	<b>120.000</b>	<b>160.421</b>	<b>38.840</b>	<b>199.261</b>	<b>166,05</b>	<b>150.000</b>
19.1.	tatimin personal të kompensimeve për anëtarët e jashtëm Këshillit të ekspertëve .	120.000	160.421	38.840	199.261	166,05	150.000

**Shtojca 2. Shpenzime që janë mbuluar nga fondi rezerv në vitin 2019**

	SHPENZIME QË DOTË MBULOHEN			NGA FONDI REZERV	
	Të planifikuara 2019	Realizuar deri më 01.11.2019	Vlerësim nga 01.11.2019 deri më 31.12.2019	Gjithsej 2019	Gjithsej 2019
Mirëmbajtje e IBM pajisjes harduerike	1.200.000	266.664	133.332		399.996
Shërbime për promovimin, organizimin dhe nxijjen e zhvillimit të sigurimit pensional me financim kapital në Republikën e Maqedonisë së Veriut	5.000.000	2.192.762	1.414.331		3.607.093
<b>GJITHSEJ</b>	<b>6.200.000</b>	<b>2.459.426</b>	<b>1.547.663</b>		<b>4.007.089</b>

**Shtojcë 3. Rezultatet e planifikuara financiare për vitin 2020**

REZULTATI FINANCIAR	
TË HYRAT E PËRGJITSHME VIJUESE TË PËLANIFIKUARA	64.050.000
SHPENZIMET E PËRGJITSHME VIJUESE TË PËLANIFIKUARA	63.785.000
REZULTATI FINANCIAR NA VITI VIJUES PARA TATIMIT (1-2) QË BARTET NË FONDIN REZERV	265.000

Ndryshimi dhe plotësimi i planit financiar bëhet nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Gjatë vitit, Këshilli i ekspertëve të Agjencisë mund të bëjë ndryshim të Planit vjetor financiar vetëm nëse bëhet fjalë për shpenzime që nuk kanë mundur të planifikohen me kohë. Për realizimin e ndryshimit, nevojitet që të dorëzohet arsyetim të Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë. Ndryshimi mund të bëhet në kuadër të të njëjtit zë por jo më shumë sesa shuma e përgjithshme e shpenzimeve të planifikuara në Planin Financiar të Agjencisë, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë.

Kryetari i Këshillit të Ekspertëve.  
Maksud Ali



The image shows a circular official stamp in blue ink. The stamp contains the text: "REPUBLIKA E MAQEDONIA", "AGJENCIA PER MBIKEDJE", "SHKUP", and "REPUBLIC OF MACEDONIA". A handwritten signature in blue ink is written over the stamp.